

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Qëndrueshmëria e Ambientit dhe Ndërmarrësia
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Semestri:	IV
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë trajton marrëdhënien ndërmjet biznesit, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, Studentët njihen me rolin e ndërmarrësisë në zgjidhjen e sfidave ekologjike, konceptet e ekonomisë qarkore, inovacionin e gjelbër, modelet e biznesit të qëndrueshëm, ESG, politikat mjedisore dhe menaxhimin e resurseve natyrore. Përmes analizave praktike, studimeve të rasteve dhe diskutimeve interaktive, studentët do të aftësohen të zhvillojnë ide biznesi që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik pa kompromentuar mjedisin.
Qëllimet e lëndës	Eshte të: pajisë studentët me njohuri themelore mbi konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndikimin e tyre në biznes, ndihmojë studentët të kuptojnë se si ndërmarrësia mund të ofrojë zgjidhje ekologjike të qëndrueshme, zhvillojë aftësitë për analizën strategjike të mjedisit të biznesit (PEST, SWOT), nxisë krijimin e ideve të gjelbra dhe modeleve të qëndrueshme të biznesit, përgatisë studentët për të vlerësuar ndikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike të ndërmarrjeve. Inkurajojë zbatimin e parimeve ESG dhe përgjegjësisë sociale të biznesit.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Shpjegojë konceptet bazë të qëndrueshmërisë dhe ndërmarrësisë së gjelbër. (ECTS: 0.5) 2. Analizojë mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të biznesit duke aplikuar mjetet strategjike. (ECTS: 1) 3. Identifikojë mundësi sipërmarrëse që ofrohen nga sfidat ekologjike dhe zhvillimet teknologjike. (ECTS: 0.5) 4. Vlerësojë ndikimin e aktiviteteve të biznesit mbi mjedisin (p.sh. LCA, ESG). (ECTS: 0.5) 5. Zhvillojë modele dhe ide biznesi të qëndrueshme dhe inovative (ECTS: 0.5) 6. Aplikoje konceptet e ekonomisë qarkore dhe menaxhimit të resurseve natyrore brenda një ndërmarrjeje. (ECTS: 0.5) 7. Paraqesë projekte të bazuara në ndërmarrësi të gjelbër dhe politika mjedisore. (ECTS: 0.5)

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	2	2	4
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)			
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			15
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi në shtjellimin e materialit duke marrë raste studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi i studenteve për raste studimi, punime seminarik-shkencore, ese apo hulumtim, punë praktike në grup dhe individuale, workshop-e për ide të gjelbërta, mësim i orientuar drejt problemeve – PBL (Problem-Based Learning) dhe duke gjetur zgjedhje sa më të mirë për problemet me të cilat ballafaqohen organizatat në fushën e ruajtjes së ambientit.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminarik.....max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti t'i kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarik - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,		

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminar (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën. Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminar	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	6
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	7
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	7
Gjithsej:	20

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjëratat, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 17 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë, studenti ka të drejtë të nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjësuar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës..... **35 pikë (%)**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jetë në gjendje të jepë përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit. **35 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

	Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klasë, etj). Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. • 70 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 30 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 2.8 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1.2 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Taticchi, P. (Ed.). (2022). Corporate sustainability in practice: A guide for strategy development and implementation. Springer. 2. Roessl, D., Bartosch, B., & Teller, C. (Eds.). (2021). Sustainable entrepreneurship: Theory, research, and practice. Routledge. 3. Paul Wetherly, Dorron Otter, 2018, The Business Environment: Themes and Issues in a Globalizing World, Oxford University Press																												
Literatura shtesë	1. Stahel, W. R. (2019). <i>The circular economy: A user's guide</i> . Routledge. 2. United Nations Environment Programme (UNEP). (2021). <i>Sustainability and circularity in the business sector: Global outlook</i> .																												
Plani i dizajnuar i mësimi:																													
Java	Ligjërata që do të zhvillohet																												
Java e parë	Prezentimi i Syllabusit dhe njoftimi me lëndën ; Është ligjëratë hyrëse, studentet njoftohen me plan-programin e lëndës, literaturën, materialet shtesë, aktivitetet e planifikuara gjatë leksioneve etj . Përkufizimi i qëndrueshmërisë së ambientit																												

	Ne kete ligjeratë studentet do te njihem me qendrueshmerine e ambientit dhe ndemrresine, Ndërmarrësia e gjelbër dhe rëndësia e saj në ekonominë moderne. qasja e lëndës dhe rezultatet e të nxënit Resultati i pritur.nr. 1.
Java e dytë	Njohuritë e përgjithshme mbi mjedisin e biznesit – Çështjet mjedisore në menaxhimin e biznesit Ne kete ligjerat studentet do te njihen me ndikimin i bizneseve në mjedis, sfidat kryesore mjedisore (klima, mbeturinat, ujërat, energjia) Praktikat themelore të biznesit të qëndrueshëm, etj. Resultati i pritur nr. 1, 4.
Java e tretë	Ndërmarrësia dhe zhvillimi i qëndrueshëm – Analiza e mjedisit të jashtëm Ne kete ligjeratë studentet do te njihen me rolin e ndërmarrësisë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, Modelet e ndërmarrjes së gjelbër, mundësitë sipërmarrëse që krijohen nga sfidat mjedisore, Diskutime interactive, etj. Rezultat i pritur nr.1, 2, 4.
Java e katërt	Vizioni, misioni dhe filozofia e organizatave – Mjedi i brendshëm i biznesit – Analiza SWOT Ne kete ligjerate do te kete ushtrime dhe ligjerata, ku studentet do te njihen me integrimin i qëndrueshmërisë në mision dhe vizion, faktorët mjedisor brenda analizës SWOT, shembuj të kompanive të gjelbra, etj. Resultati i pritur nr. 2, 3, 7.
Java e pestë	Intelegjenca Artificiale, Parashikimi i mjedisit ekonomik, politik, teknologjik, social – Analiza PEST Ne kete ligjerate studentet do te njihen me shtyllat mjedisore në analizën PEST, Futja e konceptit të ekonomisë qarkore, pastaj si Intelegjenca Artificiale përdoret për të analizuar sasi të mëdha të dhënash ekonomike, politike, teknologjike dhe sociale (PEST), Algoritmet e IA-së mund të përpunojnë të dhëna nga tregjet, raportet qeveritare, rrjetet sociale dhe trendet globale për të gjeneruar analiza më të sakta dhe dinamike. Resultati i pritur nr.1, 2, 3, 6.
Java e gjashtë	Qeverisja e biznesit, etika dhe përgjegjësia sociale Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutime me studentet per materialin e ligjeratave paraprake, pastaj do te njoftohen me ESG (Environmental, Social, Governance), Etiken e qëndrueshmërisë, praktikat e përgjegjësisë sociale të korporatave, diskutime interactive, etj. Resultati pritur nr. 3, 4, 6, 7.
Java e shtatë	Përfitimet sociale nga politikat mjedisore – Ndikimi ekonomik dhe social i bizneseve të gjelbra Ne kete ligjerate nga studentet do te kërkohet mendim për ecurinë e ligjeratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim, pastaj do te bisedohet dhe shpjegohet per qasjen komunitare, Ndërmarrjet sociale dhe të gjelbra, do te kete diskutime interactive. Resultati i pritur nr. 2, 6.
Java e tetë	Diskutime interactive për materialin e lëndës se përpunuar, Vlerësimi i dijes – Kolokfiumi i parë , Resultati i pritur nr. 1, 2, 3, 4.
Java e nëntë	Formulimi i objektivave dhe identifikimi i alternativave strategjike Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutime interactive me fokus përsëritje te ligjëratës paraprake, pastaj studentët do te njoftohen me objektivat e qëndrueshmërisë në strategjinë e biznesit, modelet e biznesit të qëndrueshëm (Sustainable Business Models), diskutime interactive.

	Rezultati i pritur nr. 3, 5.
Java e dhjetë	Biznesi dhe natyra: zhvillimi ekonomik dhe mjedisi – Dështimi i tregut – Eksternalitetet Ne kete ligjerate studentet do te njoftohen me rëndësinë e vlerësimit të ndikimit mjedisor (LCA – Life Cycle Assessment), politikat e brendshme për zvogëlimin e eksternaliteteve, Rast studimi: Analiza e mjedisit të një biznesi real Rezultati i pritur nr. 2, 4, 5, 6, 7.
Java e njëmbëdhjetë	Mjedisi i biznesit ndërkombëtar – Strategjitë e hyrjes në tregjet ndërkombëtare Ne kete ligjeratë do te kete përsëritje, studentët do te njoftohen me trendet globale të bizneseve të gjelbra, Standardet mjedisore ndërkombëtare, Diskutime interaktive, poashtu do te kete prezantime nga studentet te projekteve te tyre te para-caktuara. Rezultati i pritur nr. 3, 5.
Java e dymbëdhjetë	Politikat mjedisore të ndërmarrjeve – Modelet e menaxhimit të resurseve natyrore Ne kete ligjeratë do te kete ushtrime- përsëritje, studentët do te njoftohen me menaxhimin e energjisë, ujit, mbetjeve, standardet ISO mjedisore (ISO 14001, etj.), ekonomine qarkore në kompani, prezentime te projekteve hulumtuse nga studentet. etj. Rezultati i pritur nr. 3, 4, 5.
Java e trembëdhjetë	Ndërmarrësia dhe zhvillimi ekonomik – Prezantime nga studentët Ne kete ligjerate do te kete perseritje – ushtrime nderlidhur me temat e ligjeruara, pastaj studentet do te njoftohen me Inovacionin e gjelbër, Start-up-et e qëndrueshme, Prezentime interim të projekteve, etj. Rezultati i pritur nr.1, 5, 7.
Java e katërbëdhjetë	Nevoja për monitorimin e ndryshimit – Objektivat e analizës së mjedisit Ne kete ligjerate, studentet do te njihen me monitorimin e performancës mjedisore, Menaxhimi i qëndrueshmërisë brenda organizatave , pastaj si IA përdoret për monitorimin e ndryshimeve mjedisore si ndotja, përdorimi i resurseve natyrore, emetimet e karbonit dhe ndryshimet klimatike. Përmes sensorëve inteligjentë, analizës së të dhënave dhe mësimiit makinerik, bizneset mund të ndjekin në kohë reale ndikimin e tyre në mjedis. Poashtu do te kete edhe prezantime te studenteve. Rezultati i pritur nr. 2, 3, 4, 7.
Java e pesëmbëdhjetë	Transparenca - diskutime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar - Vlerësimi i dijes – Kolokfiumi i dytë , Rezultati i pritur nr. 2. 3, 4, 5, 6, 7.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësime dhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	